



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 871/1 Prot

Elbasan, më 5.8.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.69, datë 29.07.2025 “Për përdorimin e fondit rezervë për ” Bashkëfinancimin e projektit Përmirsimi i bancesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pafavorizuara”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir Bejtja



871
01.8.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA LIBRAZHDI
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.31.07.2025

Nr.5213 prot

Nr.69 dt.29.07.2025

“Përdorim fondi rezerve për “Bashkëfinancimin e projektit Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara ”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore “, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë “ , i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2024“Për Buxhetin e vitit 2025” ,Udhezimi plotësues nr.2 date 24.01.2025 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë 29.07.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

VENDOSI :

1. Të miratojë bashkëfinancimin e projektit “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” për vitin 2025 në vlerën 17,117,414 lekë sipas shkresës nr.8396 prot datë 24.06.2025 të Ministrisë Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit ,Drejtoria e Strehimit.

Për vitin 2025 në vlerën 3,423,483 lekë

Për vitin 2026 në vlerën 13,693,931 lekë

2. Për sigurimin e këtyre fondeve të miratojë ndryshimet buxhetore si më poshtë :

- Pakësim në strukturën buxhetore :

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera në lekë
0 0	4910	0 1	609	3,423,483 lekë Fond rezervë

- Shtim në strukturën buxhetore:

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke
0 0	1110	0 1	231	3,423,483 lekë Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit , Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social , Drejtoria e Planifikimit Kontrollit të Territorit dhe Pronës ,Sektori Juridik.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

ZV/KRYETAR E KËSHILLIT
Silvana HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LIBRAZHDI

KRYETARI

P/ VENDIM

NR ____ DATE ____/07/2025

P/Vendim
V=10

“Përdorim fondi rezerve për “Bashkëfinancimin e projektit Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara ”

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 Datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, të Ligjit Nr.9936 Datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në Ligjin Nr.115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”. Udhezimi plotësues nr.2 date 24.01.2025 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2025”, Këshilli i Bashkisë i mbledhur sot më datë ____/07/2025 me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd:

VENDOSI :

- Të miratojë bashkëfinancimin e projektit “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” për vitin 2025 në vlerën 17,117,414 lekë sipas shkresës nr.8396 prot datë 24.06.2025 të Ministrisë Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit ,Drejtoria e Strehimit.
Për vitin 2025 në vlerën 3,423,483 lekë
Për vitin 2026 në vlerën 13,693,931 lekë
- Për sigurimin e këtyre fondeve të miratojë ndryshimet buxhetore si më poshtë :
 - Pakësim në strukturën buxhetore :

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera në lekë
00	4910	01	609	3,423,483 lekë Fond rezervë
 - Shtim në strukturën buxhetore:

Grupi	Tit.	Kap.	Art .	Vlera ne leke
00	1110	01	231	3,423,483 lekë Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara
- Ndjek zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit , Menaxhimit Financiar dhe Shërbimit Social , Drejtoria e Planifikimit Kontrollit të Territorit dhe Pronës ,Sektori Juridik.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes .

KRYETARI I BASHKISE

~~MARIGLEN DISHA~~

Strehimi / 26.06.2025

4432
DT 26.06.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E STREHIMIT

Nr. 2356 / Prot.

Tiranë, më 24/6 / 2025

Lënda: Njoftim mbi fituesit e projekteve të strehimit për vitin 2025

BASHKISË LIBRAZHD ✓

Në vijim të shkresës së Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, me nr.15900, datë 18.12.2024 "Mbi fondet për projektet e strehimit për vitin 2025", nëpërmjet të cilës u njoftuan të 61 bashkitë për hapjen e thirrjes për aplikime me projekte strehimi, ju komunikojmë se Komisioni i Vlerësimit të Projekteve vendosi shpalljen fituese të Bashkisë Librazhd, me projektin "*Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara*". Vlera totale e projektit është **57,058,047 lekë me TVSH**, nga të cilat bashkia përfiton nga buxheti i shtetit vlerën prej **39,940,633 lekë** dhe bashkëfinancon vlerën 17,117,414 lekë, në masën 30% të vlerës totale të projektit. Në Tabelën nr.1 bashkëlidhur, gjeni fondin e miratuar për këtë projekt dhe nivelin e financimit për vitet 2025 dhe 2026.

Risjellim në vëmendjen Tuaj se, çdo kursim nga prokurimi do të ndahet sipas përqindjes së bashkëfinancimit dhe fondi i kursyer nga buxheti i shtetit do t'i kthehet Ministrisë. Në kuadër të monitorimit të projekteve të strehimit dhe për një mirëmenaxhim të fondeve, në vijim kërkojmë nga ana juaj, raportim periodik mujor (brenda datës 28 të çdo muaji), me informacion të përditësuar mbi ecurinë e zbatimit të kontratave, nisur nga procedura e prokurimit, lidhja e kontratës, ecuria e punimeve (në % kumulative), realizimi i fondeve e deri në marrjen në dorëzim të projektit si dhe mundësitë për realizimin e fondeve të alokuara për vitet 2025 dhe 2026.

Theksojmë se afati i fundit për lidhjen e kontratës duhet të jetë brenda muajit **Gusht 2025**. **Fondet e alokuara janë të pa-trashëgueshme për vitin pasardhës**. Nëse bashkia nuk arrin të përdorë fondet e alokuara për vitin 2025, në vitin 2026 do të përfitojë vetëm fondet e planifikuara për atë vit buxhetor.

MINISTËR
Blendi GONXHJA

Tabela nr. 1 "Fondet e miratuara për projektin"

Bashkia	Lloji i projektit	Vlera e projektit (lekë me TVSH)	Shuma që financon Bashkia	Shuma që kërkohet nga buxheti i shtetit	Shuma që mbulohet nga përfituesi	Financimi në vitin 2025	Financimi në vitin 2026
Librazhd	Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara	57,058,047	17,117,414	39,940,633		19,970,316	19,970,316